

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “K. e R.”, me seli në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V.R jurist i diplomuar, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “S.” me seli në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit S.D jurist i diplomuar, me objekt kontesti rimbursim të mjeteve në vlerë prej 324.00 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.06.2017, ndërsa me datën 09.06.2017 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.”, me seli në P., e paraqitur kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “S.”, me seli në P., për shkak të rimbursimit për aksidentin e datës 14.11.2011, në shumën e përgjithshme prej 324.00 euro (treqind e njëzet e katër euro), me kamatë prej 12 % duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim e deri në pagesën definitive.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “K. e R.”, me seli në P., ka parashtruar padi me datë 30.06.2016, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “S.”, me seli në P., duke kërkuar që e paditura t’ia paguaj në emër të rimbursimit mjetet për aksidentin e datës 14.11.2011, në shumën prej 324.00 euro , me kamatë prej 12 % duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i paditëses si në padi ashtu edhe në seancën kryesore ka theksuar se aksident i komunikacionit ka ndodh me datën 14.11.2011, në P. ku dhe është shkaktuar dëm material dhe jo material, ndërsa deri te aksidenti ka ardhur me fajin e drejtuesit të automjetit i tipit Mercedes me targa *numri I targave*, i cili është i siguruar te e paditura kështu duke vepruar sipas kërkesës për zhdëmtim të dëmit të parashtruar nga ana e të dëmtuarit paditësi dëmin e ka trajtuar dhe e ka kompensuar në shumë prej 324.00 euro, andaj dhe mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovet në tërësi si bazuar.

E paditura në përgjigje në padi dhe shqyrtimin kryesor e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi dhe ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të hudhet si të palejuar për shkak se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor të kësaj çështje juridike ka administruar këto prova si në vijim: përfundimi (rimbursimi i mjeteve i dt.08.07.2015) , polisa e sigurimeve kasko 700443 e dt.20.04.2012, fletë pagesa e lëshuar nga Banka Ekonomike e datës 23.01.2012, marrëveshja jashtëgjyqësore e dt.13.02.2012, paraqitja e dëmit në automjet pa datë, autorizimi i dt.14.11.2012, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit e dt.22.12.2011, foto dokumentacionet, raporti policor dt.14.11.2011, llogaritja e dëmit e dt.12.01.2012.

Pas shqyrtimit dhe analizës së këtyre provave dhe pretendimeve të dy palëve në procedurë Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar dhe atë konform dispozitave të nenit 376 të LMD-së, prandaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në provat e administruar gjeti se nga data e aksidentit të komunikacionit dt.14.11.2011, e deri të paraqitja e padisë dt.30.06.2016, ka vërtetuar faktin lidhur me kohën e afatshme për paraqitjen e kërkesës lidhur me përmbushjen e detyrimit sipas nenit 376 të LMD-së, kështu që nga data e shkaktimit të aksidentit dt.14.11.2011, e deri me datën 30.06.2016, si datë e paraqitjes së padisë kanë kaluar më shumë se 3 vite, andaj edhe është përmbush kushti ligjor për refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar duke iu referuar dispozitave të nenit 376 të LMD-së, në të cilën është paraparë në mënyrë decitive se kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet e paditësit se nuk mund të ketë parashkrim për shkak se paditësi i ka dërguar në mënyrë të rregullt kërkesën për rimbursim mirëpo gjykata këtë pretendim e konsideron si të pabazuar ngase duke u bazuar në nenin 391 të LMD-së, se “ *Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin*”, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas shtjellimit të çështjes juridike civile të paditëses lidhur me borxhin në vlerë prej 324.00 euro, nuk është lëshuar në administrimin e provave të tjera, për faktin se kur kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës atëherë nuk mund të vlersohen provat tjera të cilat nuk mund të jenë valide në marrjen e një vendimi meritor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç.

Nga të lartëcekurat kjo gjykatë ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar në bazë të nenit 376 dhe nenit 391 të LMD-së, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje ekonomike
III.EK.nr. 340/16 me datë 09.06.2017

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.